



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 17 prill 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1248_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe taksave të kyçje;
- Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Vendimin V_1239_2020 të datës 6 prill 2020 për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Kërkesën/aplikacionin e KEDS-it për miratimin e tarifave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 10 prill 2020,


në seancën e mbajtur më 17 prill 2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifat për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) për periudhën 1 prill 2020 - 31 mars 2021.
- II. Struktura e tarifave për OSSH, e cila do të zbatohet nga data 1 prill 2020 është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tarifat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	1.12
10 kV	€/kWh	1.46
0.4 kV	€/kWh	2.42

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org



Nr. 198/20

Data. 22.04.2020

ARSYETIM


- ↘ ZRRE më datën 10 prill 2020 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) ka pranuar aplikacionin për tarifat e OSSH-së.
- ↘ ZRRE për vendosjen e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS), ka marrë parasysh dokumentet e përgatitura, lëshuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (prill 2020 - mars 2021), i publikuar më 19 shkurt 2020; dhe
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2020 - mars 2021), i publikuar më 27 mars 2020.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, do të zbatohet nga KEDS SH.A., duke filluar nga data 1 prill 2020 deri në shqyrtimin e rregulltarifor.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfi, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Ruzhiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS), dhe
- Arkivit të ZRRE-së.